

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Winter 1-2020

### INSTITUTI I ADOPTIMIT-ASPEKTE KRAHASUESE

Doruntina Bytyqi

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Bytyqi, Doruntina, "INSTITUTI I ADOPTIMIT-ASPEKTE KRAHASUESE" (2020). *Theses and Dissertations*. 1761.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1761>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

**INSTITUTI I ADOPTIMIT-ASPEKTE KRAHASUESE**

Shkalla Bachelor

Doruntina Bytyqi

Janar / 2020

Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

Punim Diplome  
Viti akademik 2015/2016

Doruntina Bytyqi

**INSTITUTI I ADOPTIMIT-ASPEKTE KRAHASUESE**

Mentore: Dr. Egzona Osmanaj

Janar / 2020

Prishtinë

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të  
pjeshme për Shkallën Bachelor

## **ABSTRAKT**

Adoptimi është një ndër format themelore për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur përmes të cilës fëmijës i ofrohet një familje e përhershme ligjore me të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve biologjik. Në këtë punim duke u bazuar kryesisht në legjislacionin pozitiv të Republikës së Kosovës por dhe në legjislacionin shqiptar dhe atë maqedon jepen shpjegime të rëndësishme lidhur më procedurën e themelimit të marrëdhënies së adoptimit. Ky punim ka si qëllim të jap një përshkrim të qartë të procesit të adoptimit si institut i së drejtës familjare. Punimi fillon më një historik të shkurtër të institutit të adoptimit ,më pas trajtohen temat të cilat zënë vend kryesor në këtë punim si: nocioni apo përkufizimi i adoptimit; kushtet për themelimin e adoptimit; efektet juridike të themelimit të adoptimit ; procedura për themelimin e adoptimit sipas ligjlacionit pozitiv në Kosovë duke e krahasuar më legjislacionin shqiptar dhe atë maqedon.

**Fjalë kyçe:** mbrojtje, fëmije, adoptim, procedurë etj.

## **MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME**

Dëshirojë të shpreh falenderimin për disa persona të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, për të cilët shprehi mirnjohjen time të thellë.

Dua të falenderoj profesoret Egzona Osmanaj për ndihmen që më ofroi gjatë punës sime dhe për kontributin e saj në finalizimin e punimit tim të diplomes. Faleminderit për zëmërsisht

Gjithashtu u jam mirnjohëse Dekanës Jorida Xhafaj dhe të gjithë profesorëve për ndihmen profesionale dhe këshillat e herëpashërëshme .

Falenderoj miqtë e mi për mbështetjen që më dhanë në çdo rast ,veqanarisht Dhurata Matoshi dhe Ermira Gegaj . Faleminderit nga zemra !

Së fundmi dëshirojë të falenderoj edhe familjen time nga të cilët kam marrë mbështetje si nga ana morale ashtu edhe financiare , u jam mirnjohëse gjithnjë !

# **PËRMBAJTJA**

|  |           |
|--|-----------|
| <b>1 HYRJE .....</b>   | <b>1</b>  |
| <b>2 SHQYRTIMI I LITERATURES .....</b>   | <b>2</b>  |
| <b>2.1 Evolucion i institutit të adoptimit .....</b>   | <b>2</b>  |
| <b>2.2 Informacion i përgjithshur mbi “birësimin” .....</b>  | <b>4</b>  |
| <b>2.3 Perceptimi rreth Birësimit.....</b>   | <b>5</b>  |
| <b>2.3.1 Aftësia për birësim e prindërve të ardhshëm .....</b>   | <b>7</b>  |
| <b>2.3.2 Përgaditja për birësim .....</b>  | <b>8</b>  |
| <b>2.3.3 Mbështetja pas birësimit .....</b>  | <b>8</b>  |
| <b>2.3.4 E drejta për konfidencialitet .....</b>   | <b>8</b>  |
| <b>2.4.1 Korniza ligjore në Kosovë në kuadër të adoptimit .....</b>  | <b>8</b>  |
| <b>2.4.2 Adoptimi në të drejtën tonë ligjore.....</b>  | <b>9</b>  |
| <b>2.5 Procedura e adoptimit në Kosovë .....</b>   | <b>12</b> |
| <b>2.5.1 Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave.....</b>  | <b>12</b> |
| <b>2.5.2 Shtetësia.....</b>  | <b>12</b> |
| <b>2.5.3 Dokumentet e nevojshme për adoptim.....</b>   | <b>13</b> |
| <b>2.5.4 Miratimi i kërkesës për adoptim.....</b>  | <b>13</b> |
| <b>2.5.5 Regjistrimi.....</b>  | <b>13</b> |
| <b>2.5.6 Periudha provuese.....</b>  | <b>14</b> |
| <b>2.5.7 Refuzimi i kërkesës për adoptim.....</b>  | <b>14</b> |
| <b>2.6 Praktika aktuale e birësimeve të fëmijëve në Kosovë .....</b>   | <b>14</b> |
| <b>2.7 Birësimet brenda Kosovës .....</b>  | <b>15</b> |
| <b>2.7.1 “Birësimet kur parashtruesi i kërkesës është “shtetas/banor i huaj” .....</b>   | <b>15</b> |
| <b>2.8 Korniza e Ligjit mbi familjen i Republikës së Maqedonisë lidhur me aplikimin e masave juridike për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe mbrojtjen e tyre – .....</b> | <b>17</b> |
| <b>2.8.1 Mbrojtja juridike më e përshtatshme – Adoptimi .....</b>  | <b>18</b> |

|  |           |
|--|-----------|
| <b>2.9 Korniza e Ligjit mbi familjen i Republikës së Maqedonisë lidhur me aplikimin e masave juridike për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe mbrojtjen e tyre .....</b> | <b>19</b> |
| <b>2.9.1 Kushtet për themelimin e adoptimit.....</b>   | <b>19</b> |
| <b>2.9.2 Roli i Komisionit gjatë zhvillimit të procedurës për themelimin e adoptimit .....</b>   | <b>20</b> |
| <b>2.9.3 Aplikimi i masave sociale për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore .....</b>   | <b>20</b> |
| <b>2.9 Birësimi në Shqipëri.....</b>   | <b>21</b> |
| <b>2.9.1 Birësimi në këndvështrimin historik .....</b>   | <b>22</b> |
| <b>2.9.2 Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) .....</b>  | <b>23</b> |
| <b>2.9.3 Dokumentacioni për birësim .....</b>  | <b>24</b> |
| <b>2.9.4 Komiteti Shqiptar i Birësimit.....</b>  | <b>25</b> |
| <b>3 DEKLARIMI I PROBLEMIT .....</b>   | <b>27</b> |
| <b>4 METODOLOGJIA .....</b>  | <b>29</b> |
| <b>5 Prezantimi dhe analiza e rezultateve .....</b>  | <b>30</b> |
| <b>5.1 Prezantimi I rezultateve.....</b>   | <b>30</b> |
| <b>5.2 Analiza e rezultateve .....</b>   | <b>30</b> |
| <b>6 KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME .....</b>   | <b>31</b> |
| <b>6.1 Përfundime.....</b>   | <b>31</b> |
| <b>6.2 Rekomandime .....</b>   | <b>32</b> |
| <b>7 BIBLIOGRAFIA .....</b>  | <b>34</b> |

## **FJALORI I TERMAVE**

**DKSHMS**- Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

**DPSF**- Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes KDF Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

**KOMF**- Koalicioni i OJQ–ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

**LFPL** - Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

**MSH**- Ministria e Shëndetësisë

**MPMS**- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

**OJQ** - Organizata jo-qeveritare

**QPS** - Qendra për Punë Sociale

**QKUK**- Qendra Klinike Universitare e Kosovës

**QVSHM**- Qendra për Vendosije Afatshkurtër dhe Afatmesme të Fëmijëve Nevojtarë në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë SOS

**SOS**- Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

**UNICEF** - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë



## **1 HYRJE**

Adoptimi është një nga format themelore të mbrojtjes juridiko-familjare të fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe me përkujdesje joadekuate prindërore. Në vendin tonë institucioni i adoptimit është i rregulluar kryesisht me Ligjin për Familjen dhe me Ligjin për Shërbimet Sociale, por dispozitat që kanë të bëjë me të, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, janë të shpërndara edhe në ligje të tjera dhe akte nënligjore.

Objekti kryesor i këtij punimi është shqyrtimi analitik i themelimit të marrëdhënies juridike të adoptimit dhe pasojat që dalin nga themelimi i kësaj marrëdhënie. Në këtë punim janë paraqitur në mënyrë të detajuar shumë aspekte të institucionit të adoptimit si: kushtet ligjore për themelimin e adoptimit, efektet juridike të adoptimit etj. Po ashtu janë vënë në pah specifikat e rregullimit ligjor të adoptimit të shteteve fqinje të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Kështu, me zbatimin e metodës krahasimore të studimit, janë vënë në pah specifikat e rregullimit ligjor të adoptimit në vendin tonë në raport me rregullimin ligjor në vendet e përfshira në studim. Në mënyrë të veçantë në punim trajtohet procedura që duhet ndjekur për themelimin e adoptimit sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë duke e krahasuar me legjislacionin pozitiv në Shqipëri dhe Maqedoni. Punimi është i ndarë në tre kapituj, kështu:

Kapitulli i parë, - *Historiku i Institutit të Adoptimit;*

Kapitulli i dytë - *Adoptimi sipas së drejtës pozitive në Kosovë;*

Kapitulli tretë - *E drejta e adoptimit sipas së drejtës pozitive në Shqipëri dhe Maqedoni.*

## 2 SHQYRTIMI I LITERATURES

### 2.1 Evolucioni i institutit të adoptimit

Adoptimi është institucion i lashtë shoqëror dhe juridik. Fillimet e adoptimit i gjejmë në vitet 2000 para erës së re në Mesopotami, në Kodin e Hamurabit (United Nations, 2009 ‘Child Adoption: Trends and Policies’). (file:///C:/Users/Admin/Downloads/Doktoratura-Galsvinda-BIBA-%20(1).pdf) Aty nuk flitet në mënyrë të drejtpërdrejtë për adoptimin, por për një aspekt të poligamisë. Në kod lejohet poligamia, por ligjërisht njihet vetëm një bashkëshorte. Kështu, vetëm fëmijët e lindur nga bashkëshortja mund të trashëgojnë nga i ati. Të lindurit nga konkubinatat përjashtohen nga trashëgimia, përveçse në rastet kur i ati i njeh duke shqiptuar fjalët “bijtë e mi”, që lejojnë fitimin e të njëjtës gradë me fëmijët e tjerë.

Të tjera gjurmë i gjejmë në Greqinë e lashtë, tek populli athinas.

Adoptimi njihej ekskluzivisht për krijimin e mundësisë së trashëgimit të emrit të familjes. Kjo dukej qartë nga fakti që vetëm meshkujt mund të adoptoheshin. Në fakt kjo shihet në mentalitetin juridik grek sipas së cilit adoptimi nuk do të ishte i drejtpërdrejtë, si në Romë, që të krijonte një lidhje pushteti mes të adoptuarit dhe adoptuesit, por vetëm duke krijuar mes tyre një marrëdhënie farsnore artificiale. Në Greqinë e lashtë adoptimi nuk kërkonte ceremoni solemne si në Romë, por kryhej vetëm nëpërmjet hartimit të një akti të shkruar. Me qytetërimin romak, birësimi zhvillohet si një institut i vërtetë dhe i mirëfilltë me karakteristika juridike në planin e marrëdhënieve adoptues dhe i adoptuari.

Institutit i adoptimit ishte mjaft i shpehur në Romën e lashtë, por ka qenë i njohur edhe në Greqi, Egjipt, Mesopotami dhe në Babilioni. (H. Podvorica (2005) “E Drejta Familjare” - Prishtinë - Faqe 203) Nën patria potestas hynin të gjithë fëmijët e posalindur, nëse prindërit e tyre ishin qytetarë romakë dhe nëse kishin lindur gjatë kohë vazhdimit të martesës romako juridikisht të rregullt. Sipas vullnetit të pater familiasit, në kuadrin e familjes së tij mund të hynin disa persona edhe pas momentit të lindjes. Hyrja në rrethin e familjes apo nën patria potestas të ndonjë personi në ndonjë moment pas lindjes, quhej adoptim. Adoptimi duhej të bëhej patjetër me forma të parashikuara juridikisht.

Format e adoptimit ishin adoption, adrogatio dhe legitimation. Adoptio apo përvetësimi i fëmijës nën patria potestas të huaj bëhej shumë shpesh në Romën e lashtë. Atëherë qytetarët më të pasur romakë, për shkaqe ekonomike, ndërsa qytetarët pa fëmijë, për shkak të vazhdimit të familjes dhe kultit familjar, përvetësonin fëmijët e kusherinjëve ose fëmijët e proletarëve të varfër. Forma më e lashtë e adoptimit ka qenë mjaft e paqartë. Kur ishte fjala për përvetësimin e fëmijës së huaj mashkull duhej bërë mancipimin e trefishtë (I. Puhan “E Drejta Romake”

Prishtinë - Faqe 192)formal, ndërsa kur ishte fjala për përvetësimin e personit femër bëhej mancipimi i njëfishtë formal.

Pas mancipimeve të bëra, pater adoptansi ose përvetësuesi dhe titullari i gjerathershëm i pushtetit atënor mbi të përvetësuarin,duhej të shkonin patjetër para magjistratit dhe në një kontakt formal (in jure cessio) ta merrnin vendimin që fëmija i takon familjes së pater adoptansi(Po aty - fq.192)t.

Në të drejtën klasike dhe pasklasike janë bërë shumë ndryshime në materien e adoptimit. Parashikohej që adoptuesi duhej të ishte patjetër së paku 18 vjet më i madh se i adoptuari. Forma e adoptimit ishte reskripti i perandorit ose procesverbali i mbajtur para organit kompetent shtetëror. Përveç kësaj, adoptimi ndahej në adoption plena dhe adoption minus plena. Në adoptio plena, personi i adoptuar ndërpriste çdo lidhje me familjen e mëparshme, ndërsa në adoption minus plena ai vërtet, fitonte të gjitha të drejtat në familjen e adoptuesit, mirëpo nuk humbte të drejtat themelore në familjen e atit natyror.

Adrogatio ishte mënyra solemne e përvetësimit të personave meshkuj madhor sui juris(Po aty - fq.193). .

Me rastin e aktit të adrogimit, që kryhej para comita calata, i adroguari hiqte dorë nga familja e tij, nga kulti i tij familjar dhe kalonte si anëtar i familjes së përvetësuesit.

Meqë me aktin e adrogimit shuhej zotësia juridike e personave të adroguar, duhej patjetër që më parë të rregulloheshin të gjitha marrëdhëniet pronësore në të cilat gjendeshin të përvetësuarit para këtij akti. Kur comitia calata nuk mblidheshin më, adrogimi lejohej me rescript të perandorit. Që atëherë mund të adrogoheshin edhe gratë.

Për adrogimin juridikisht të rregullt, kërkohej që përvetësuesi të mos ishte më i ri se 60 vjet, që të mos kishte fëmijë natyror,që të mos kishte as fëmijë të adoptuar, që të mos ishte më i varfër se i adoptuari dhe që, nëse ishte fjala për përsosin e mitur, të garantonte se nuk do ta emancipojë.(Po aty - fq.193).

Në kohën e perandorit Konstandin hyri edhe legitimation si formë e re e konstituimit të pushtetit atënor. Legitimatio ose legjitimi përdorej si formë e konstituimit të pushtetit atënor vetëm sa i përket fëmijëve të lindur në konkubinat (liberi naturales).

Fëmijët e lindur në konkubinat, edhe pse të lindur si jo legjitim, mund të barazoheshin të paktën me të drejtat e fëmijëve të lindur në martesën romake: ose pas kurorëzimit të mëparshëm.(I. Puhani "E Drejta Romake" Prishtinë. Faqe 193).Pra, në të drejtën romake, adoptimi trajtohej si një institut në vete.

Fillimisht ai lindi si shkak i nevojave fetare dhe me vonë për interesa politike dhe ekonomike. Adoptimi njihej si e drejtë vetëm e burrit dhe më pas i kaloi edhe gruas.(Aferdita Deda -

Birësimi - 2017). Në botën antike aspekti ekonomik ishte primar. E drejta gjermanike njohu një lloj të veçantë birësimi që realizohej në mënyrë solemne para asamblesë dhe që kishte më shumë pasoja morale sesa juridike. E veçantë ishte ceremonia e birësimit, e cila konsistonte në prerjen e flokëve dhe në dorëzimin e armëve. Me shumë gjasa ligji më influencues i institutit të adoptimit në periudhën moderne është Kodi Civil Francez i vitit 1807 i cili njihet edhe si Kodi i Napoleonit.

Ky kod i njeh të drejtën e adoptimit personave të cilët kanë arritur moshën madhore mbi 50 vjeç, të cilët nuk kishin fëmijë ose pasues legjitim. (Po aty - fq 22).

Në shekullin e kaluar, ndryshe nga kohët e lashta, qëllimi parësor i adoptimit ishte mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon qëllimi i adoptimit. Arsyet janë nga më të shumtat, sepse pas luftës së dytë botërore, një numër i madh i fëmijëve të mitur, mbetën pa përkujdesjen e domosdoshme të prindërore.

Në të drejtën e tanishme, adoptimi është një mënyrë shoqërore e mbrojtjes së fëmijëve të mitur. Qëllimi kryesor i adoptimit është që fëmijët pa prindër të fitojnë mbrojtjen prindërore dhe përkujdesjen, dhe që ata persona nga arsye të ndryshme nuk kanë fëmijë, të mundën ta kompensojnë këtë me adoptimin e fëmijëve tjerë. (Azemi & B.Ymeri - ADOPTIMI - Fq.260).

## **2.2 Informacion i përgjithshur mbi “birësimin”**

Adoptimi (birësimi) është një institut i lashtë juridik dhe shoqëror. Në kuptimin sociologjik, adoptimi paraqitet qysh para lindjes së shtetit dhe të drejtës, por që ka ndryshuar me zhvillimin e shoqërisë (Vojislav Bakić - E Drejta Familjare - fq. 267). Nga aty janë edhe karakteristikat e këtij instituti dhe qëllimet e tij kanë qenë të ndryshme në periudha dhe vende të ndryshme (Dr. Hamdi Podvorica).

Për këtë arsye edhe në kohën tonë ky institut është rregulluar juridikisht në mënyrë të ndryshme në vende të ndryshme (Po aty). Ky institut ka qenë i njohur që në Romën e lashtë, në Greqi, Egjipt, Mesopotomi dhe Babiloni. Gjatë kohës, ka ndryshuar edhe qëllimi i adoptimit, si p.sh. në kohën e lashtë qëllim dominues i adoptimit të fëmijëve të kushërinjve ose fëmijëve të proletarëve të varfër, ka qenë nevoja e mbrojtjes së pasurisë së qytetarëve të pasur dhe ruajtja e vazhdimësisë së familjes, të traditës dhe të kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë (Ana).

Kjo tregon se adoptimi i meshkujve madhorë atëherë nuk bëhej për mbrojtjen e interesave të të adoptuarit, por para së gjithash për shfrytëzimin e punës së tij dhe për mbrojtjen e interesave të gjenit, pra të familjes e cila adoptonte (birësonte) personat meshkuj madho (Prof. Dr. Hamdi Podvorica - E Drejta Familjare - fq. 203) rë. Disa vende të botës nuk e njohin adoptimin si institut juridik dhe shoqëror. (Duncan)

Madje, adoptimi është i ndaluar edhe me norma ligjore. Në vendet ku u zhvillua ky institut i rëndësishëm ka dominuar qëllimi privat juridik i adoptimit, ndonëse ka qenë i shprehur edhe qëllimi i tij shoqëror. Nuk ka dyshim se adoptimi ka rëndësi edhe për birësuesit, ngase ata në këtë mënyrë plotësojnë dëshirat e veta për të qenë prindër dhe për të pasur fëmijë (Kosovës).

Pengesën objektive të quajtur mospasje të fëmijëve, pa të cilën askush nuk ka mundur të bëhej prind, ata e eliminojnë me rrugë ligjore, duke i adoptuar fëmijët e mitur të lindur nga persona të tjerë dhe të mbetur pa përkujdesje prindërore.

Në shekullin e kaluar, ndryshe nga kohët e lashta, qëllimi parësor i adoptimit bëhet mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon qëllimi i adoptimit (Prirucni).

### **2.3 Perceptimi rreth Birësimit**

Një studim i realizuar në Australi në lidhje me faktin se sa kanë dëgjuar australianët për birësimin rezultoi se 39 % (Nations) e të pyeturve kanë dëgjuar shumë apo pak në lidhje me të, edhe se pjesa më e madhe e rasteve që ata kanë dëgjuar në media për birësimet lidhet kryesisht me birësimin e fëmijëve nga persona VIP.

Sipas këtij studimi birësimi shihet nga banorët si diçka shumë pozitive, pasi familjet në kohët moderne mund të formohen në mënyrë të ndryshme edhe birësimi mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Madje ata theksojnë se birësimi ju ofron një mundësi atyre që nuk e kanë, fëmijët e birësuar i sjellin gëzim familjes etj (Peterson).

Në lidhje me pyetjen nëse ekziston ndonjë konotacion negativ në lidhje me birësimin, pjesa më e madhe e të intervistuarve në këtë studim shprehen mohues ndaj saj, por në kontrast me këtë ata e shohin birësimin si diçka që familjet e bëjnë nga keqardhja për fëmijët.

Po ashtu, nga ana tjetër, fëmijët e birësuar përballen me çështje të lidhura me identitetin në mënyra të ndryshme në periudha kohore të ndryshme, (Schechter) fëmijët parashkollorë mësojnë rreth historisë së birësimit/lindjes; fëmijët në shkollë fillore luftojnë me ndjenjat e refuzimit, adoleshentët kërkojnë një mirëkuptim më të madh si të familjes birësuese ashtu edhe të familjes së origjinës dhe janë të pavarur, ndërsa të birësuarit e rritur janë në kushte të tilla për të bërë zgjedhje mbi martesën dhe në marrjen e vendimit për të kërkuar prindrit që i kanë sjellë në jetë nëse ata nuk janë të njohur.

Kjo njihet në atë që Silverstein dhe Roszia (Silvestrin) e quajtën 7 çështjet kryesore të birësimit: humbja, refuzimi, faji edhe turpi, hidhërimi, identiteti, familjariteti, zotërim edhe kontroll(The Evan B. Donaldson Adoption Institute, 2010).

Në një studim të realizuar nga Instituti i Kërkimit të Minesotës(The Evan B. Donaldson Adoption Institute)në një krahasim midis fëmijëve të birësuar në moshë të vogël edhe atyre të birësuar në adoleshencë, rezultoi se të rinjtë e adoptuar kishin nivele më të larta të sjelljeve kriminale, përdorimit të drogës si dhe rezultate më të ulëta në shkollë.

Në një analizë krahasuese midis Francës, Belgjikës dhe SHBA-ve, në lidhje me kulturën e birësimit, studjuesja Lammers shprehet se ‘kultura nuk është identitet kombëtar dhe populli francez është shumë selektiv’. Në rast të birësimit të një fëmije nga një shtet tjetër, kwtij fwmije do t'i duhen tre gjenerata që të konsiderohet Francez”. (Meredith Lammers).

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekzistojnë tre lloje kryesore të birësimit: të hapur, të mbyllur dhe gjysëm të mbyllur. Emërtimet i referohen statusit të lindjes së fëmijës dhe të dhënave të birësimit. Çdo birësimi i caktohet statusi në varësi të rrethanave të birësimit dhe preferencës së mamasë biologjike.

Konkretisht, për amerikanët një birësim i mbyllur është një birësim sekret, ku fëmija mund të mos informohet kurrë për historinë e tij personale (Browne). E kundërta është birësimi i hapur në të cilin edhe familja birësuese edhe biologjike; ku familja biologjike përfshin prindërit, që e kanë lindur fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar; kanë ndërveprim në jetën e fëmijës ose të paktën kur fëmija të ketë arritur një moshë specifike. Birësimet gjysëm të mbyllura mbulojnë pjesën tjetër të mundësive të birësimit (Meredith Lammers).

Tendenca në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është për favorizimin e birësimit të hapur. Në ditët e sotme shumica e birësimeve në SHBA (Institute)janë fëmijë të rritur, disa prej tyre janë me ngjyrë. Edhe profili i gruas dhe burrit që birëson ka ndryshuar në mënyrë drastike, ky kontingjent përbëhet më shumë nga njerëz të cilët nuk janë fertilë, me ngjyrë, beqar, gay.

Në Belgjikë (Meredith Lammers, 2008) dhe në Francë ka dy lloje kryesore të birësimeve, e thjeshtë edhe e plotë. Adoptimi i plotë është ajo që Amerikanët do ta konsideronin një birësim ‘normal’, ku fëmija është shkëputur nga familja e saj/tij biologjike dhe ligjërisht i bashkohet një familje tjetër. Adoptimi i thjeshtë përdoret për të përshkruar një fëmijë që nuk është shkëputur plotësisht nga familja e saj/tij biologjike.

Një pjesë e mirë e shtetasve Francez (Browne)preferojnë të kryejnë më shumë birësime individualisht për tre arsye kryesore: Nënisa raste të birësimeve agjencitë birësuese nuk mund të ndërhyjnë, pasi janë birësime të cilat duhet të kryhen vetëm nga individë.

Francezët janë shumë krenar për liritë e tyre personale dhe ekziston një ndjesi e përgjithshme që individët duhet të birësojnë vetë pa ndërhyrjen nga qeveria; birësimet individuale duken më pak të kushtueshme, gjë e cila i bën të gjithë të ndihen më mirë. Në Francë prindërit që duan të birësojnë edhe që bashkëpunojnë me agjencitë e birësimit duhet të deklarojnë të gjitha të ardhurat e tyre (Peterson).

Rezultatet e dala nga studimet e realizuara për identifikimin e nevojave të familjeve birësuese apo të periudhës pas birësimit, kanë konstatuar se: shumica e fëmijëve të birësuar, për shkak se ata kanë vuajtur nga deprivimi i hershëm apo keqtrajtimi vijnë në familjet e reja me rreziqe më të mëdha në drejtim të aspekteve psikologjike, fizike, zhvillimit apo ndryshimeve në sjellje (The Evan B. Donaldson Adoption Institute); përdorimi i shërbimeve mjekësore nga familjet birësuese është gati tre herë më i madh se i familjeve me fëmijë biologjikë, kjo si pasojë e një dëshire dhe nevoje më të madhe për ndihmë; ndonëse zhvillimi i suportit të specializuar post birësues ka filluar që në 1980, ai ka pësuar një ngadalësim dhe tashmë këto shërbime përfshijnë informimin, referimin, edukimin, trajnimin, mentorship-in, ndërhyrjet në raste krizash apo edhe këshillimin terapeutik.

Megjithatë, familjet adoptuese janë më shumë të ngjashme se sa të ndryshme me familjet që rrisin fëmijë biologjikë. Studimet mbi rezultatet e birësimit tregojnë se 90 % e prindërve birësues pavarësisht nga lloji i birësimit janë të kënaqur nga eksperiencia e tyre dhe do të zgjidhnin sërish të birësonin (The Evan B. Donaldson Adoption Institute).

### **2.3.1 Aftësia për birësim e prindërve të ardhshëm**

Birësimi ka për qëllim të ofrojë familjen më të përshtatshme, duke iu përgjigjur nevojave të saj, një minori që ka përjetuar situata traumatizuese (paaftësi ose pamundësi e familjes së tij të origjinës për tu përkujdesur edhe pse i përket asaj) e nganjëherë është mbartës ndryshimesh kundrejt shoqërisë që do të presë..

Familja birësuese duhet pra të jetë paraprakisht e njohur si e kualifikuar dhe e përshtatshme për të siguruar, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, mbrojtjen dhe respektin e njëfëmije me këtë të kaluar dhe me këto karakteristika (The Evan B. Donaldson Adoption Institute). Një studim psiko-mjeko-social i një familje të tillë duhet pra realizuar para se të ndërmerret praktika e birësimit.

Ky studim duhet per te konfirmuar ose per te mohuar aftesite biresuese te familjes, aftesi keto qe duhet te jene objekt i nje vertetimi zyrtar. Ne rastin e biresimit midis familjaresh, aftesite biresuese te biresuesve duhet te jene njekohesisht objekt i nje studimi e nje vertetimi.

### **2.3.2 Përgaditja për birësim**

Fëmija, familja biresuese dhe familja biologjike duhet te pergaditen per biresimin. Nje biresim do ti pergjigjet interesave te te gjithë personave te perfshire nese nje pergatitje e duhur do ti lejojë secilit te kuptojë cilat do te jene ndërlikimet, afatshkurtër dhe afatgjate, te biresimit në jetën e secilit.

Pervec kesaj pergaditja duhet te ndihmojë minorin dhe familjen biresuse per te perballuar me qetësi takimin dhe fazën e parë te jetës së bashku. (Duncan)

### **2.3.3 Mbështetja pas birësimit**

Kërkesa për ndihmë pranë shërbimeve të kualifikuara të mbështetjes pas birësimit duhet të bëhet e mundur për minorët, për prinderit biresues, për motrat dhe vëllezerit, ashtu dhe për prinderit biologjikë me qëllim që të pergjigjen për problemet e mundshme të mëtejshme dhe të sqarohen ose të zgjidhen problemet që mund te identifikohen. (Emanuel)

### **2.3.4 E drejta për konfidencialitet**

Minori, prinderit biologjikë dhe familja biresuese kanë të drejtën e konfidencialitetit dhe të respektimit të jetës së tyre private. Aksesit në dokumentet e tyre do të jetë i mirë përcaktuar. Nëse do të gjykohet e nevojshme, në interesin më të mirë të fëmijës, publikimi i informacioneve personale do të përhapet, me mënyrat që do të konsiderohen të përshtatshme, pranë personave të seleksionuar për aftesinë e tyre ose për interesin e treguar në propozimin e zgjidhjeve, por nuk do të lejohet aksesit i një publiku të gjerë të paidentifikuar në mjete komunikimi si interneti (Erden)

### **2.4.1 Korniza ligjore në Kosovë ne kuadër të adoptimit**

Ligji për Familjen i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/7 (Familjen) i jep gjykatave në Kosovë kompetencën ekskluzive për të gjykuar biresimet. (Neni 161(1) - Rregullorja e UNMIK-ut 2006/7 mbi Shpalljen e Ligjit për Familjen). Ligji për Familjen është legjislacioni më i fundit në Kosovë që rregullon procedurën e biresimit, dhe po ashtu është më i veçanti. Përbën një kod të tërë lidhur me biresimin, duke i vendosur parimet ligjore mbi të cilat bazohet biresimi dhe kushtet paraprake që duhet përmbushur që një biresim të kryhet, si dhe rregullon të gjitha aspektet e procedurës së biresimit.



Si i tillë, sipas doktrineve si të lex posteriori ashtu edhe të lex specialis (Ligji i veçante derogon ligjin e përgjithshëm) ky ligj qartë mbizotëron legjislacionin të mëparshëm dhe më të përgjithshëm për birësim në Kosovë. (Dr. Hamdi Podvorica)

Ligji për Familjen parasheh mbikëqyrjen nga ana e gjykatës të të gjitha aspekteve të birësimit, duke u nisur nga kërkesa fillestare për birësim. Kërkesa mund të bëhet nga prindi i ardhshëm birësues ose, në rastin e fëmijëve që janë “përcaktuar pa përkujdesje prindërore”, nga “autoriteti përkatës.” (Neni 182(4) - Ligji për Familjen).

Ai i jep gjykatës kompetencën ekskluzive mbi procedurat e kërkuara për të the marr pëlqimin e fëmijës, si dhe pëlqimin e prindërve biologjik ose zëvendësve të tyre. Ai po ashtu i cakton gjykatës përgjegjësinë për ti ndihmuar “palëve në të gjitha fazat e procedurës”, duke i njoftuar të dyja palët “të birësuarin dhe birësuesin për qëllimet ligjore, edukative dhe morale si dhe pasojat e birësimit” dhe ta njoftojë të birësuarin për “natyrën juridike, të drejtat dhe detyrat e ardhshme.” (Nations)

Gjykata është përgjegjëse për të bërë të gjitha hetimet, dhe të merr parasysh “të gjitha mendimet e arsyetuara të sociologut psikologëve, mjekëve dhe të ekspertëve tjerë” lidhur me “përshtatshmërinë e palës birësuese.” (Neni 184(1) - Ligji për Familjen). Ajo mund që sipas zgjedhjes së vet të, “kërkojë këshilla nga organi i kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi birësimin.” (Po aty).

Ajo mund po ashtu të “mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga organi i kujdestarisë, nga shërbimet sociale dhe nga ekspertë tjerë në lëmin e përkujdesjes së fëmijës mbi kushtet e birësimit. Gjatë periudhës së mbledhjes së dhënave, organi i kujdestarisë ka për obligim që t’u ofrojë si prindërve të fëmijës ashtu edhe prindërve të ardhshëm birësues “përgatitjen e domosdoshme.” Sipas kërkesës së fëmijës, pëlqimi i organit të kujdestarisë për birësim do të zëvendësohet nën rrethana të caktuara me atë të prindërve të fëmijës.

#### **2.4.2 Adoptimi në të drejtën tonë ligjore**

Ligji për Familjen i Kosovës, nuk e bënë ndarjen në adoptim të plotë dhe adoptim jo të plotë. Duke mos i pasur parasysh kriteret e njohura dhe të pranura shkencore, rregullimi normativ i institutit të adoptimit në të drejtën tonë është specifik, dallon nga shumë të drejta të tjera, ngase përzier karakteristikat dhe veçoritë e veçanta të dy llojeve të birësimit, gjë kjo që është në papajtueshmëri me traditën dhe përvojën historike të zhvillimit të adoptimit (Prof. Dr. Hamdi Podvorica - E Drejta Familjare fq. 20). Sipas nenit 167 të Ligjit për Familjen i Kosovës, me adoptim mes palës adoptuese dhe të adoptuarit themelohen të njëjtat të drejta dhe detyrime që

ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve<sup>382</sup>. Me adoptim fëmija shkëput lidhjet me familjen e origjinës.

Në bazë të nenit 11.1 të Ligjit për Trashëgimin e Kosovës, i adoptuari trashëgon në mënyrë të barabartë sikurse edhe pasardhësit i tij. Pra, ai humb të drejtën që të trashëgojë në familjen e origjinës prej momentit të adoptimit. Kush mund të jetë i adoptuar. Për të adoptuar një person duhet të plotësohen disa kushte (Familjen):

- a) të jetë i lindur gjallë,
- b) të jetë fëmijë i mitur,
- c) të mos jetë në gjini gjaku me adoptuesin.

Vetëm fëmija i lindur gjallë mund të adoptohet. Sipas nenit 189 të LFK, nuk mund të ketë themelim të adoptimit. Sipas nenit 166 të LFK-së, është paraparë një periudhë provuese tremujore brenda së cilës duhet të provohet nëse mundet apo nuk mundet të arrihet qëllimi i adoptimit. Nëse gjatë kësaj kohe provuese, mund të konstatohet se mund të arrihet qëllimi i adoptimit atëherë mund të lidhet adoptimi (Dr. Hamdi Podvorica). Periudha provuese, do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë që gjykatës i siguron raport sipas nevojës.

Disa vende kanë paraparë që fëmija mund të adoptohet vetëm pasi që të ketë mbushur moshën e caktuar me ligj. P.sh. Britania e Madhe ka paraparë që fëmija mund të adoptohet pasi të ketë mbushur moshën 6 mujore të jetës, Çekosllovakia – një vit. (Ana)

Me nenin 169 të LFK, është paraparë që pëlqimi për adoptim nuk mund të jepet para se fëmija të ketë mbushur tetë javë të jetës. Kusht tjetër për të adoptuar fëmijën është që fëmija i cili adoptohet të jetë i mitur. LFK ka paraparë në nenin 174 se mund të adoptohet vetëm fëmija i mitur.

Nuk mund të adoptohet fëmija i mitur që është në gjini gjaku me adoptuesin. Ky ndalim ka të bëjë me personat në gjini gjaku në vijë të drejtë pa kufij, pavarësisht nga shkalla e afërsisë, pra për të gjithë të paralindurit dhe të paslindurit. Po ashtu nuk mund të adoptojë as vëllai as motra vëllaun apo motrën e vet. Kjo do të thotë se adoptimi është i ndaluar edhe mes personave në gjini gjaku në vijë të tërthortë deri në shkallë të dytë. (Dr. Hamdi Podvorica)

Në nenin 177 të LFK-së, është paraparë se nuk mund të adoptohet personi në vijën e drejtë, as vëllai dhe motra. Kujdestari nuk mund të adoptojë të kujdesurin e vet përderisa organi kompetent të mos e shkarkoj nga detyra e kujdestarit (Prof Dr. Hami Podvorica).

Edhe adoptuesi duhet ti plotësoj disa kushte për të mundur me adoptuar fëmijën e mitur. Ai duhet të plotësojë këto kushte, të cilat janë të precizuara me dispozita ligjore (Vojislav Bakić):

1. Adoptuesi duhet të ketë zotësinë për të vepruar,
2. Të ketë cilësitë e nevojshme personale për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore (neni 175 i LFK)
3. Të mos vuajë nga ndonjë sëmundje psikike e diagnostifikuar ose ka ngecje në pikëpamje psikike si dhe personi që lëngon nga ndonjë sëmundje ngjitëse që do të rrezikonin shëndetin e fëmijës,
4. Të ketë mbushur moshën 21 vjeçare. Fëmijën e mitur mund ta adoptojnë edhe bashkëshortët.

Në rastet kur bashkëshortët adoptojnë fëmijë, njëri prej tyre duhet të ketë mbushur moshën 25 vjeçare kurse tjetri moshën 21 vjeçare (neni 176 par. 1 dhe 2 i LFK). Nëse fëmijën e adopton vetëm njëri nga bashkëshortët, atëherë kërkohet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër.

Mirëpo, mund të ndodhë që njëri bashkëshort ta adoptojë fëmijën e bashkëshortit tjetër. Në këtë rast fëmija i adoptuar, fiton statusin e fëmijës së përbashkët të bashkëshortëve. Po ashtu, është e nevojshme që të ekzistoj edhe dallimi në moshë në mes të fëmijës së mitur dhe adoptuesit, sepse me adoptim krijohet ato raporte që krijohen në mes të prindërve dhe fëmijëve(LFK - neni 189/166/169)..

Diferenca tepër e madhe në moshë mes adoptuesit dhe të adoptuarit, nuk është e lejueshme, ngase ndryshimi i theksuar në moshë pengon qëllimin e vërtetë që synon adoptimi(LFK - neni 175/176.1.2/neni 172)..

*Pëlqimi i prindërve* - Sipas dispozitave ligjore, kur fëmija i mitur ka gjallë të dy prindërit, ose njërin prej tyre kërkohet pëlqimi i tyre për adoptimin e fëmijës. Dhënia e pëlqimit ka rëndësinë e heqjes dorë nga e drejta prindërore. Sipas nenit 172 të LFK, deklarata e pëlqimit duhet ti deklarohet gjykatës dhe bëhet e plotfuqishme në kohën e dorëzimit. Pëlqimi nuk mund të bëhet me kusht dhe me përcaktimin e kohës e as mund të bëhet nga përfaqësuesi. (Dr. Hamdi Podvorica)

Ky pëlqim është i përvokueshëm, por mund të anulohet nëse është dhënë në lajthitje, shtrëngim ose mashtrim. Duke pasur parasysh faktin se adoptimi është në funksion të mbrojtjes së interesave të fëmijës të mitur dhe pa përkujdesje prindërore, kur është fjala për fëmijët e braktisur dhe lënë pa përkujdesje prindërore, ligjvënësi ka përcaktuar afatin kohor prej një viti për kthimin e prindit dhe për dhënien e pëlqimit për adoptim, por nëse brenda këtij viti prindi

nuk kthehet dhe nuk jep pëlqimin për adoptim, adoptimi mund të bëhet edhe pa pëlqimin e tij, sepse pritja më e gjatë do të cenonte interesat e fëmijës.

## **2.5 Procedura e adoptimit në Kosovë**

Procedura e adoptimit është në kompetencë të gjykatës. Gjykata mund të kërkojë këshilla nga organi i kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim. Adoptimi themelohet me akt juridik. Ai themelohet në procedurë jo kontestimore para gjykatës me parashtrimin e propozimit nga prindi adoptues.

Kompetenca tokësore për themelimin e adoptimit caktohet në bazë të vendbanimit të adoptuesit ose ku ata e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët si dhe para gjykatës sipas vendbanimit të të adoptuarit (Ana).

### **2.5.1 Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave**

Në procedurën e adoptimit përjashtohet publiku. Kjo bëhet për faktin se duhet të ruhen interesat e fëmijës së mitur që adoptohet dhe ruajtja e fshehtësisë. Procesverbali dhe dokumentet e themelimit të adoptimit paraqesin sekret zyrtar (Silvestrin).

Vendimi për adoptim u dorëzohet vetëm palëve të cilat marrin pjesë në procedurën e adoptimit në pajtim me ligjin. Gjykata kompetente dhe Organi i kujdestarisë janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve, të mbledhura gjatë procesit të adoptimit (LFK - neni 162).

### **2.5.2 Shtetësia**

Adoptues mund të jetë vetëm qytetari i Kosovës, përjashtimisht shtetasi i huaj mund të jetë palë adoptuese nëse fëmija nuk mund të adoptohet në Kosovë dhe ekzistojnë arsye të bazuara për veprimin e tillë nëse fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar, që nuk mund ti ofrohet në Kosovë.

Procedura për inicimin e kërkesës për adoptim. (neni 182 i LFK) (Dr. Hamdi Podvorica).

Procedura për adoptim fillon me propozimin për adoptim nga ana e personit adoptues. Personi i cili kërkon të adoptojë, së bashku me prindërit e fëmijës së mitur që do të adoptohet, propozimin ia dorëzojnë gjykatës.

Propozimit i bashkëngjitet pëlqimi i shkruar i prindërve biologjikë të fëmijës dhe dokumentet e tjera relevante. Pas paraqitjes së kërkesës në gjykatë, gjykata e përcjell lëndën për vlerësim profesional në Qendrën për Punë Sociale. Menaxheri i rastit, i caktuar nga QPS për vlerësimin e familjes, duhet të kërkojë nga prindërit adoptues ti plotësojnë dokumentet e nevojshme (Schechter).

### **2.5.3 Dokumentet e nevojshme për adoptim**

Prindërit të cilët duan të adoptojnë fëmijë duhet ti dorëzojnë në MPMS këto dokumente: kërkesën me shkrim të prindërve potencial adoptues, certifikatën e lindjes (për të dy prindërit), certifikatën e martesës (jo më të vjetër se gjashtë muaj), certifikatën e mjekut me të cilën dëshmohet aftësia e prindërve potencialë adoptues për adoptim të fëmijës, mendimin e psikologut (përshkrim i detajuar për prindërit potencialë adoptues), mendimin e ekspertëve profesionalistë nga shërbimi profesional brenda QPS, certifikatën ose vërtetimin mbi gjendjen ekonomike (përfshirë pasurinë), dokumentin mbi të ardhurat personale të prindërve adoptues (kontratat e punës, certifikatat për ushtrimin e veprimtarisë/biznesit etj.) (Nderkombetar) fotokopjet e dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimin), certifikatën nga gjykata se prindërit adoptues nuk janë nën hetime për ndonjë veprë penale, certifikatën nga gjykata me të cilën vërtetohet se nuk i është marrë e drejta prindërore dhe zotësia e veprimit.

Gjykata ka të drejtë të mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga organi i kujdestarisë, nga shërbimet shoqërore dhe nga ekspert të tjerë në lëmin e përkujdesjes së fëmijës mbi kushtet e adoptimit (Dr. Hamdi Podvorica).

### **2.5.4 Miratimi i kërkesës për adoptim**

Nëse gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet për adoptim të parapara me LFK, do të themelojë adoptimin. Për themelimin e adoptimit nevojitet prania e adoptuesit, e bashkëshortit të tij, e prindërve, përkatësisht kujdestarit të të adoptuarit, si dhe prania e të adoptuarit kur është më i vjetër se 10 vjet, me përjashtim kur deri në këtë moshë ka qenë në kujdes juridik, ruajtje dhe edukim te personi që dëshiron të adoptojë (Ana).

Deklarata e pëlqimit të palëve pjesëmarrëse duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës. Pas përfundimit të procedurës së adoptimit duhet të nënshkruhet procesverbali nga palët dhe duhet t'u lexohet personave prezentë. Gjykata është e detyruar që të mbajë të gjitha shënimet dhe ti ruaj dokumentet për personat e adoptuar dhe procesin e adoptimit (Peterson).

### **2.5.5 Regjistrimi**

Në bazë të nenit 188 të LFK, gjykata kompetente ia dërgon menjëherë procesverbalin për themelimin e adoptimit organit kompetent për regjistrim në librin amëz të të lindurve, palës dhe organit të kujdestarisë. Adoptuesi regjistrohet si prind i të adoptuarit.

Me këtë rast organi i kujdestarisë mund të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose atij t'ia bashkëngjisë një ose më shumë emra të tjerë. Ai mund ta bëjë këtë vetëm kur konstaton se është në interesin më të mirë të fëmijës.

### **2.5.6 Periudha provuese**

Adoptimi, si rregull nuk do të themelohet derisa adoptuesi të kujdeset për fëmijën për një kohë të arsyeshme të përcaktuar nga gjykata por që nuk kalon periudhën tre mujore.

Kjo periudhë kohore do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë e cila gjykatës i siguron raport sipas nevojës (Dr. Hamdi Podvorica).

Gjykata merr vendim në fund të gjykimit. Mirëpo, gjykata mund të vazhdoj gjykimin për një periudhë shtesë deri në tre muaj nëse në mes palëve ka mospajtime ose për shkak të rrethanave të tjera të arsyeshme, të cilat janë vënë në dijeni nga organi i kujdestarisë ose nga ekspertët për fëmijë të përfshirë në procedurë (LFK - neni 188).

### **2.5.7 Refuzimi i kërkesës për adoptim**

Nëse gjykata, pas çmuarjes së të gjitha rrethanave dhe provave të siguruara dhe mendimit të marrë sipas detyrës zyrtare, gjen se adoptimi do të jetë i dëmshëm për të adoptuarin, apo se me adoptim do të dëmtohen interesat e fëmijës që adoptohet, ajo me aktvendim do ta refuzojë kërkesën për adoptim.

Shuarja e adoptimit Me nenin 198 të LFK, është paraparë mundësia që adoptimi të shuhet ex officio, që nënkupton faktin se adoptimi është i shkëputshim. Gjykata kompetente mund të shuajë marrëdhënien e adoptimit me procedurë të veten, nëse për çfarëdo arsye kjo bëhet e nevojshme për mirëqenien e femiut (Dr. Hamdi Podvorica).

## **2.6 Praktika aktuale e birësimeve të fëmijëve në Kosovë**

Monitorimi i OSBE-së i procedurave të birësimit në Kosovë, kombinuar me intervistat me institucionet përkatëse, zbulojnë një shumëllojshmëri konfuzë të praktikave. Birësimet nuk gjykohen ekskluzivisht nga gjykatat, siç parashihet me Ligjin për Familjen; përderisa gjykatat gjykojnë disa raste të birësimit, shumica e birësimeve sot gjykohen nga organet administrative, në rend të parë nga QPS-të, por gjithashtu, në disa raste nga paneli i sipërpërmendur për vendosjen e fëmijës, që vepron sipas autoritetit në kuptim të Udhëzimit Administrativ.

OSBE është në veçanti e brengosur për këtë praktikën e fundit, për tri arsye (Vojcic).

Së pari, udhëzimi Administrativ është një urdhër i lëshuar nga dega e ekzekutivit, dhe si i tillë është qartazi formë dytësore apo plotësuese e legjislacionit. Është shkelje serioze e sundimit të ligjit që të lejohet një legjislacion plotësues ta mbizotërojë legjislacionin parësor me të cilin është drejtpërdrejtë në konflikt (Ana).

Së dyti, Udhëzimi Administrativ ishte lëshuar në bazë të Ligjit mbi Shërbime Sociale dhe Familjare në kohën kur ky I fundit ka përfunduar së rregulluari çfarëdo kategorie të birësimeve, pasi që Ligji për Familjen hyri në fuqi katër muaj të plota para lëshimit të Udhëzimit Administrativ (Marital).

Së treti, tipari qendror i Udhëzimit Administrativ është dallimi që bën ndërmjet dy kategorive të fëmijëve, fëmijëve të braktisur dhe atyre prindërit e të cilëve janë të njohur, një dallim që përmban diskriminim pa kurrfarë justifikimi të arsyeshëm, dhe I cili, si i tillë shkel ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.(Ana)

## **2.7 Birësimet brenda Kosovës**

Ligji për Familjen nuk bën dallim ndërmjet procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës së braktisur dhe procedura që duhet të ndiqet në rast të fëmijës prindërit e të cilit janë të njohur (përveç pjesëve të veçanta lidhur më atë se si duhet të iniciohetkërkesa për birësim). (Browne)(Neni 182 - Ligji për Familjen).

Përkundër kësaj, OSBE ka mësuar se në Kosovë është de facto i vendosur sistemi i birësimit në dy nivele, ku shumica e rasteve që përfshijnë fëmijët prindërit e të cilëve janë të njohur gjykohen nga gjykatat, ndërsa shumica e rasteve që përfshijnë fëmijët e braktisur vendosen ose nga QPS-te ose nga paneli për vendosjen e fëmijëve, që është në kundërshtim si me Ligjin për Familjen ashtu edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. (Familjen)

### **2.7.1 “Birësimet kur parashtruesi i kërkesës është “shtetas/banor i huaj”**

Siç është cekur më herët, Ligji për Familjen parashih se “shtetasi/banori i huaj” mund të birësoj fëmijë në Kosovë vetëm nën rrethana të veçanta. Rrethanat e tilla përfshijnë rastet kur fëmija nuk mund të birësohet në Kosovë dhe/ose ku “fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar, që nuk mund t’i ofrohet në Kosovë.”(Po aty neni 179 paragrafi 3).

“Pëlqimi paraprak nga organi administrativ, kompetent për punët e politikës sociale” kërkohet për birësime të tilla. Ligji për Familjen nuk veçon se cilat kritere duhet të përdoren për të vendosur se kur fëmija nuk mund të birësohet në Kosovë (Dr. Hamdi Podvorica). OSBE ka monitoruar një rast kur gjykata lejoi një kërkesë për birësim, edhe përkundër asaj që as nuk ka marr pëlqimin e QPS-së e as nuk ka shqyrtuar çështjet e përmendura më lartë.Duket se gjykata ka tej-shikuar faktin se kërkesa ishte parashtruar në bazë të Nenit 179 të Ligjit për Familjen dhe se propozuesi ishte “shtetas/banor i huaj.”

Kjo është befasuese pasi që propozuesi tërhoqi vëmendjen e gjykatës lidhur me vendbanimin e tij të huaj, në raste të shumta gjatë rrjedhës së procedurës (Donaldson).

Është akoma më befasuese se gjykata në një pikë bëri të ditur se do të kërkohej pëlqimi i QPS-së. Në rast nuk shqyrtohen fare kriteret e Nenit 179, d.m.th. se a ka mundur fëmija të birësohet në Kosovë, dhe/ose a ka ai nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar, që nuk mund t'i ofrohet në Kosovë (Familjen).

QPS-të dhe paneli për vendosjen e fëmijës janë po ashtu të përfshirë në gjykimin e disa birësimeve që kanë të bëjnë me “shtetas/banor[ë] të huaj.”(Udhëzimi Administrativ - neni 5 paragrafi 10). Siç është rasti me gjykimin e birësimeve lokale, ka dallime të konsiderueshme në praktikë nga rajoni në rajon, madje edhe brenda secilit rajon (Dr. Hamdi Podvorica).

Dy QPS në rajonin e Prizrenit i thane monitoruesve të OSBE-së se secila nga këto të dyja kishin iniciuar nga një rast të birësimit që përfshinte një propozues që jeton jashtë Kosovës. Çdo njëra nga këto QPS përcjelli rastin e vet te paneli për vendosjen e fëmijës, që gjykoi dhe miratoi të dy birësimet.

Në rajonin e Pejë/Peć, një QPS konfirmoi se ata kishin gjykuar një rast të “birësimit ndër-shtetëror.” (Ana). Pas marrjes së mendimit nga paneli për vendosjen e fëmijës, QPS-ja morri vendimin përfundimtar me të cilin aprovoi birësimin. KDF parasheh se birësimet e fëmijëve do të jenë “të autorizuara vetëm nga organet kompetente” të cilët duhet të vendosin “në pajtim me ligjin dhe procedurat e aplikueshme”. Po ashtu obligon autoritetet për birësim që të “sigurojnë se fëmijët e përfshirë në birësime ndër-shtetërore të kenë mbrojtje dhe standarde të barabarta me ato që ekzistojnë në rastet e birësimeve nacionale”. (Kajtazi).



## **2.8 Korniza e Ligjit mbi familjen i Republikës së Maqedonisë lidhur me aplikimin e masave juridike për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe mbrojtjen e tyre –**

Legjislacioni mbi të drejtën familjare në RM çështjen e vendosjes së fëmijës në adoptim e rregullon me një numër të kufizuar të neneve, edhe atë prej nenit 110 deri në nenin 155.

Neni 110 al.1 përmban përkufizimin e institucionit të adoptimit: (Erden)“Me adoptim krijohen marrëdhënie si ato të cilat krijohen me lindje (adoptim i plotë) apo vetëm marrëdhënie të cilat ekzistojnë në mes prindërve dhe fëmijëve (adoptim jo i plotë).” Ky ligj jep një definicion shumë të shkurtër dhe jo të plotë sa i përket adoptimit, duke mos i përmbajtur elementet esenciale të cilët do ta kishin kompletuar këtë institucion, edhe atë, qëllimin, mënyrën e themelimit të kësaj marrëdhënie dhe kategorinë e fëmijëve që mund të adoptohen.

Për të dhënë definicionin e adoptimit, duhet theksuar disa elemente shumë të rëndësishme, që një nocion e bëjnë më komplet dhe më të qartë. Autorë të ndryshëm japin definicione të ndryshme sa i përket nocionit të adoptimit.

P.sh Sipas koautorëve të librit ‘Obiteljsko pravo’ - (Mira Alinčić)- Adoptimi paraqet një institut juridiko-familjar, me anë të cilit në rrugë juridike themelohet marrëdhënia prindërore midis fëmijës së mitur të huaj (i adoptuari) dhe një personi madhor (adoptuesi), edhe atë me një akt juridik të organit kompetent. Profesor Gani Oruçi, nuk jep një definicion në kuptimin klasik lidhur me atë se çka në të vërtetë kupton me adoptim.

Sipas tij : Midis adoptuesit dhe të adoptuarit themelohet marrëdhënie e ngjashme me marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve. Sipas profesorit Gani Oruçi , vet akti I themelimit të adoptimit është kontratë në formë solemne, kurse marrëdhënia që krijohet me anë të kësaj kontrate është marrëdhënie e adoptimit, ose familje sipas adoptimit (E drejta familjare).

Me birësim vendoset midis birësuesit dhe të birësuarit në një marrëdhënie birësimi, e cila emiton atë natyroren .Adoptimi paraqet institucion juridik dhe shoqëror, me anë të cilit midis adoptuesve dhe fëmijëve të adoptuar themelohet marrëdhënie prindërore, të cilat, varësisht nga lloji i adoptimit janë identike me marrëdhënien prindërore, adoptimi themelohet me akt juridik, d.m.th në rrugë artificiale, e jo në rrugë natyrore si gjinia e gjakut (martesore dhe jashtëmartesore), ashtu që gjinia sipas adoptimit njihet si gjinia civile(Prof.dr Liljana Spirovic).

Pra, adoptimi paraqet institucion juridiko- familjar dhe shoqëror, me anë të të cilit krijohet marrëdhënie prindërore, me anë të një akti juridik të dhënë nga ana e organit kompetent, i cili akt përcakton rrugën artificiale të themelimit të kësaj marrëdhënie, (Marital) por qëllimi dhe

funkcioni i të cilës imiton natyroren ashtu që fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore u mundëson plotësimin e kësaj mungese familjare, dhe çifteve që nuk kanë fëmijë u mundëson plotësimin e qëllimit të pasjes së fëmijës, kurse personave që kanë fëmijë realizimin e një akti human, dhe në këtë mënyrë duke themeluar gjininë e adoptimit midis adoptuesit dhe të adoptuarit me të paslindurit e tij (adoptimi jo i plotë) ose themelohet gjini adoptimi midis adoptuesit dhe kushërinjve të tij me të adoptuarit dhe pasardhësit e tij (adoptim i plotë) (Mira Alinčić).

### **2.8.1 Mbrojtja juridike më e përshtatshme – Adoptimi**

Çdo fëmijë ka të drejtë për përkujdesje dhe rritje në një familje funksionale dhe të shëndoshë, dhe vetëm në këtë mënyrë ata mund të zhvillojnë potencialin e tyre emocional e intelektual dhe të rriten të shëndetshëm dhe të respektueshëm. (Neni 113 Ligji mbi familjen gazeta zyrtare nr. 83/2004).

Këtë do ta ndërlihd edhe me dispozitën ligjore se: Një nga të drejtat elementare të fëmijëve është edhe e drejta të jetojë me prindërit e tij (neni 50 al.1 LF gazeta zyrtare e RM-së nr.83/2004)<sup>2</sup> . Mirëpo kjo e drejtë e fëmijëve mund të kufizohet me disa pengesa të natyrës juridike ose faktike. Ky lloj kufizimi, nuk konsiston në humbjen e të drejtës për të jetuar me prindërit, por konsiston në pamundësinë e realizimit të së drejtës në kuptimin e plotë të fjalës (jeta e përbashkët me prindërit biologjik).

Kufizimi i jetës me prindërit biologjik paraqet në njërën anë edhe mundësinë e adoptimit të atij fëmije ( d.m.th me vet faktin që fëmija jepet në adoptim, ai vazhdon jetën e tij pa prindërit biologjik, me prindërit tani më të quajtur adoptues).

Në Republikën e Maqedonisë, çështja e fëmijëve të adoptuar është e rregulluar me Ligjin mbi familjen të vitit 1992 , dhe me disa ligje tjera të veçanta, edhe atë me Ligjin mbi mbrojtjen sociale (gazeta zyrtare e RM-së nr.21/2006) , Ligjin mbi trashëgiminë(gazeta zyrtare e RM-së nr. 47/1996)Ligjin për emrin personal. Në punim janë shfrytëzuar nenet sipas tekstit të spastruar të Ligjit mbi familjen, gazeta zyrtare nr.83/2004.

Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, gazeta zyrtare nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, gazeta zyrtare nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit mbi familjen, gazeta zyrtare nr.33/2006 3 08/1995), Ligjin mbi evidencën amë (gazeta zyrtare e RM-së nr. 08/1995), Ligjin mbi të drejtën ndërkombëtarë private Ligjin mbi shtetësinë (gazeta zyrtare e

RM-së nr.45/2004). Republika e Maqedonisë gjithashtu ka ratifikuar Konventën Evropiane për adoptimin e fëmijëve .

Mirëpo, duke patur parasysh, rëndësinë e mbrojtjes ligjore dhe institucionale të kësaj kategorie të fëmijëve, është më se i nevojshëm përpilimi i një ligji të veçantë i cili do të përmbante dispozita kryesisht për mbrojtjen juridike të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, pra siç janë: vendosja e fëmijëve në një familje tjetër , vendosja e fëmijëve në jetimore, adoptimi dhe kujdestaria ndaj tyre.

Duhet potencuar faktin se IshRepublika Socialiste e Maqedonisë ka patur në fuqi ligj të veçantë i cili ka rregulluar institucionin e adoptimit, Ligji mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1973, kurse në vendet e Ish-Jugosllavisë gjithashtu ka patur ligj mbi adoptimin e fëmijëve i vitit 1947, gjegjësisht Ligji themelor mbi adoptimin i vitit 1965.(rta Mandro-Bilalli)

## **2.9 Korniza e Ligjit mbi familjen i Republikës së Maqedonisë lidhur me aplikimin e masave juridike për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe mbrojtjen e tyre**

Legjislacioni mbi të drejtën familjare në RM(gazeta zyrtare nr.83/04), çështjen e vendosjes së fëmijës në adoptim e rregullon me një numër të kufizuar të neneve, edhe atë prej nenit 110 deri në nenin 155. Neni 110 al.1 përmban përkufizimin e institucionit të adoptimit: “Me adoptim krijohen marrëdhënie si ato të cilat krijohen me lindje (adoptim i plotë) apo vetëm marrëdhënie të cilat ekzistojnë në mes prindërve dhe fëmijëve (adoptim jo i plotë).”

### **2.9.1 Kushtet për themelimin e adoptimit**

Sa u përket kushteve për themelimin e adoptimit, që në fakt edhe janë nën kornizën e masave juridike për vendosjen e një fëmije në adoptim, Ligji mbi familjen përmban kushtet që një fëmijë duhet ti plotësojë që të adoptohet, kushtet që një person duhet t'i 7 (Arta Mandro-Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E drejta familjare, Tiranë, 2006, fq.643-6) plotësojë për të adoptuar fëmijë si dhe kushtet formale dhe materiale të organin kompetent për zhvillimin e procedurës për themelimin e adoptimit. Në këtë pjesë do të fokusohem vetëm në aplikimin e masave juridike ndaj fëmijës që duhet të adoptohet.

Masat juridike për vendosjen e një fëmije në adoptim duhet të zbatohen duke pasur pikësynim Interesin dhe Sigurimin e fëmijës.

Ligji precizon se vetëm personi i mitur mund të adoptohet, edhe atë përcakton moshën minimale për vendosjen e fëmijës në adoptim (Adoptimi mund të themelohet më herët pas moshës tre muajsh të fëmijës) . Është periudha kur fëmija më mirë mundet t'u përshtatet kushteve të familjes së re, duke mos e përjetuar mungesën e prindërve biologjik e sidomos të nënës.

Kur fëmija adoptohet në moshën kur tani më e ka të njohur faktin se nuk ka kush të përkujdeset për të, atëherë është pak më vështirë që karakterit dhe nevojave të fëmijës t'u përshtaten kushtet në të cilët jetojnë adoptuesit

### **2.9.2 Roli i Komisionit gjatë zhvillimit të procedurës për themelimin e adoptimit**

Adoptimi themelohet para Komisionit të formuar nga ministri për punë dhe politikë sociale në pajtueshmëri me dispozitatnligjore. Komisioni luan rol të rëndësishëm prej momentit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga adoptuesit potencial e deri në sjelljen e vendimit përfundimtar për adoptim.

Komisioni përbëhet prej një personeli me persona të kualifikuar me përvojë prej 15 viteve<sup>13</sup> në fushën e adoptimit, edhe atë: jurist, punëtor social, psikolog dhe pedagog. Duke patur parasysh, marrëdhëniet që themelohen midis të rriturve dhe fëmijëve veçanërisht kur është fjala për adoptimin e plotë, dhe nevojën për vendosjen e marrëdhënieve harmonike dhe të përbashkëta në familje, është i patjetërsueshëm zbatimi i procedurës për ndjekjen e periudhës së adaptimit para se të themelohet adoptimi. (Ligji mbi familjen - gazeta zyrtare - nr. 83/2004)

Mirëpo, duhet patur parasysh se ky kontrollim duhet të realizohet vetëm atëherë kur do të zbatohen të gjitha metodat e rëndësishme profesionale dhe të sigurohen të gjitha parakushtet e operacionalizuara, kushtet për zbatimin e formës së adoptimit për pjesëmarrësit konkret në procedurë, si dhe sjellja e përfundimeve ekipore për ekzistimin e komplementaritetit të përshtatshëm midis adoptuesve potencial, nevojave dhe karakteristikave të fëmijës.

### **2.9.3 Aplikimi i masave sociale për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore**

Kushtetuta e RM-së proklamon obligimin e shtetit për mbrojtjen e fëmijëve e fëmijëve(neni 42 al.1) dhe veçanërisht mbrojtjen e fëmijëve pa prind dhe pa përkujdesje prindërore.

Gjithsesi, adoptimi është masë juridike më e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, mirëpo jo çdo fëmijë i kategorisë së lartpërmendur ka fatin që të adoptohet, andaj shteti me mekanizmat e veta duhet të ofrojë mundësi tjetër për t'u ndihmuar këtyre fëmijëve.

Ministria për punë dhe politikë sociale e RM-së, nën korniza të programit Mbrojta Sociale, fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore u ofron këto forma të mbrojtjes: • të drejtën e vendosjes në institucionet (jetimore) për përkujdesje sociale- u ndihmon fëmijëve që të përgatiten për jetë të pavarur dhe për inkuadrimin në marrëdhënie pune ([http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/konecna\\_alb.doc](http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/konecna_alb.doc)).

Masat juridike që ofrohen në kuadër të këtyre institucioneve mbrojtëse janë: sigurimi i banimit, ushqimi, veshja, përkujdesja, ndjekja e shkollës fillore dhe të mesme, organizimi i ndihmës profesionale për zotërimin e suksesshëm të programeve edukativo-arsimore, organizimi i formave të ndryshme të punës dhe jetës së këtyre fëmijëve si dhe përkujdesi për shëndetin e tyre. Këtë të drejtë, fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore e gëzojnë deri në mbarimin e shkollës së mesme.

Alternativë tjetër për t'u ndihmuar këtyre fëmijëve është Vendosja në familje tjetër 23, këtë të drejtë mundet ta shfrytëzojnë deri në mbarimin e shkollës së mesme. • të drejtën në mbrojtje shëndetësore, • të drejtën në ndihmë financiare- për fëmijët të cilët deri në arritjen e moshës 18 vjeçare kanë gëzuar statusin e fëmijës pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore dhe i cili fëmijë nuk ka asnjë burim financiar.

Fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore gëzojnë edhe të drejtën e shfrytëzimit të pensionit familjar nëse janë nën përkujdesjen e personit të 23 Format, masat dhe shërbimet e mbrojtjes sociale, 2007, nr. 2.1.8.4, Enti Shtetëror për statistikë, Shkup, 30.05.2008 - Gjatë vitit 2007 janë vendosur në familje tjetër gjithësej 324 fëmijë, prej të cilëve 247 janë larguar nga familja për shkak të problemeve familjare, 1 për shkak të devijimeve në personalitet dhe sjellje, 31 fëmijë për shkak të pengesave psikike, 8 fëmijë për shkak të pengesave fizike, dhe 37 fëmijë për shkaqe tjera. Marrë nga raporti i Ministrisë për punë dhe politikë sociale ' Pasqyra sociale në Republikën e Maqedonisë', Shkup, 2008.

## **2.9 Birësimi në Shqipëri**

Legjislacioni shqiptar e shikon birësimin si një mundësi për jetë familjare të përhershme në familjen birësuesi si për fëmijën të cilit i mungon ose është i privuar nga mjedisi familjar ashtu edhe në rastin e fëmijës jo të privuar nga ky mjedis. Kjo procedurë birësimi shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës që i është privuar ose jo nga mungesa e mjedisit familjar, i sigurohet një jetë e re. Kur procesi i birësimit përfundon me anë të një vendimi të gjykatës së shkallës së arë që është i përvokueshëm, (i parikthyeshëm), statusi ligjor i fëmijës kalon nga ai i prindërve biologjik, tek prindërit birësues. Në këto rrethana, të dhënat në certifikatën e lindjes së fëmijës, ndryshojnë certifikatë të re. (<http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/ligji-per-biresimin.pdf>)

Vendi ynë nuk ka një sistem ligjor të mjaftueshëm që mbulon nevojat e të rinjve që janë në përkujdesje apo që dalin nga përkujdesja, veçanërisht të atyre që largohen shumë më herët. Për këtë arsye, është i nevojshëm krijimi i shërbimeve pas përkujdesjes, qëndrimi në përkujdesje

deri në përfundim të shkollës së mesme, ngritja e qendrave ditore pritëse që ofrojnë shërbime për të rinjtë (16-18 vjeç) dhe implementimi i politikave të trajnimit profesional dhe punësimit për kategoritë e të rinjve që janë larguar nga përkujdesja.

Birësimi është alternativa më e mirë për kujdesin që shtrihet në fëmijë të braktisur ose jetimë, ngaqë ai respekton plotësisht parimin e interesave më të mira të fëmijës, duke njohur të drejtën e tij për t'u rritur në një mjedis familjar. (<http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/ligji-per-biresimin.pdf>)

Në procesin e birësimit i kushtohet vëmendje e veçantë shëndetit të fëmijës dhe mirëqenies së tij emocionale, duke gjetur për të një mjedis familjar që të mund t'i ofrojë fëmijës sa më shumë dashuri, siguri, ushqim, kujdes mjekësor dhe arsimim që të jetë e mundur. Është një institucion që ka rëndësi të shumëfishtë.

### **2.9.1 Birësimi në këndvështrimin historik**

Në vendin tonë rregullimi juridik i birësimit u përfshi në Kodin Civil të Mbretërisë Shqipëtare, i cili hyri në fuqi më 1 prill 1929. Në të vërtetë Kodi Civil përdor termin “adoptim”. Në këtë Kod parashikohet parimi i interesit më të lartë të të birësuarit. Sipas tij, birësimi mund të bëhet vetëm nëse ka shkaqe të arsyeshme dhe është i dobishëm për të birësuarin.

***Kodi Civil i vitit 1929***, parashikon kushtet që duhet të plotësojë birësuesi për të birësuar një fëmijë. Mund të birësojë vetëm personi që në kohën e birësimit nuk kishte as fëmijë, as të paslindur legjitimë që kishin mbushur moshën 40 vjeç dhe që kishte të paktën 15 vjet diferencë me personin që do të birësohej. Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare parashikon të drejtën e të birësuarit për të mbajtur lidhjet me familjen e origjinës dhe për të gëzuar të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj. Ky Kod njeh të ***drejtën e revokimit*** të birësimit. Revokimi bëhet nga gjykata për shkaqe shumë të rënda mbi kërkimin e birësuesit ose të birësuarit (Neni 274 I Kodit Civil të vitit 1929)

Birësimi u rregullua në mënyrë ***më të plotë*** me Ligjin nr.602, datë 19.05.1948 “*Mbi adoptimin*”, pasi me këtë ligj u përcaktuan më gjerë kushtet dhe mënyrat e lidhjes së birësimit, të drejtat dhe detyrat e birësuesit dhe të të birësuarit si dhe rastet e pushimit të tij (revokimi i birësimit).

Për kryerjen e procedurave duhej pëlqimi i të dy prindërve biologjikë të të birësuarit ose i kujdestarit të tij, si dhe pëlqimi i të miturit kur ai kishte mbushur moshën 10 vjeç. Me birësimin nuk lindin, midis të birësuarit dhe gjinisë së birësuesit, raporte gjinie, kjo sepse ligji njihte vetëm birësimin e revokueshëm (jo të plotë).

Birësimi u rregullua në mënyrë *më të plotë* me Ligjin nr.602, datë 19.05.1948 “*Mbi adoptimin*”, pasi me këtë ligj<sup>[19]</sup> u përcaktuan më gjerë kushtet dhe mënyrat e lidhjes së birësimit, të drejtat dhe detyrat e birësuesit dhe të të birësuarit si dhe rastet e pushimit të tij (revokimi i birësimit). Për kryerjen e procedurave duhej pëlqimi i të dy prindërve biologjikë të të birësuarit ose i kujdestarit të tij, si dhe pëlqimi i të miturit kur ai kishte mbushur moshën 10 vjeç. Me birësimin nuk lindin, midis të birësuarit dhe gjinisë së birësuesit, raporte gjinie, kjo sepse ligji njihte vetëm birësimin e revokueshëm (jo të plotë).

Me dekretin nr.3327, datë 1.9.1961 **u ndryshua** neni 18 i ligjit nr.602 datë 19.5.1948 “*Mbi adoptimin*”. Sipas këtij ndryshimi, birësuesit kishin mundësinë që të kërkonin të regjistroheshin si prindërit e të birësuarit, duke i dhënë atij mbiemrin, amësinë dhe atësinë e tyre, për realizimin e këtyre të drejtave duhet që birësuesit të ishin bashkëshortët (ose të ve) dhe të merrej pëlqimi i prindërve biologjikë, kujdestarit të fëmijës dhe i vetë fëmijës që do të birësohej nëse kishte mbushur moshën 14 vjeç. Në këtë ligj parashikohet pushim/ revokimi i birësimit, i cili realizohet, me kërkesë të të birësuesit për shkaqe më rëndësi ose kur arrihej një marrëveshje mes tyre.

**Kodi i Familjes** miratuar me ligjin nr. 4020, datë 20.6.1965, që hyri në fuqi në datën 1.01.1966, shënonte një tjetër hap me rëndësi në zhvillimin e institutit të birësimit.

Parashikohet birësimi në interes të të miturit, duke vendosur mes birësuesit dhe të birësuarit lidhje të njëjta si ato midis fëmijëve dhe prindërve biologjikë. Në ndryshim nga legjislacioni pararendës, lejohet birësimi i një madhori me kusht që në kohën e miturisë të jetë rritur nga birësuesi. Gjithashtu, të drejtat dhe detyrimet midis të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë dhe gjinisë së tij nga ana tjetër, pushojnë. (Me dekretin nr.3327 me datë 1.9.1961 u ndryshua neni 18 i ligjit nr.602 datë 19.5.1948 “*Mbi adoptimin*”)

### **2.9.2 Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF)**

Eshtë ratifikuar nga qeveria shqiptare në shkurt 1992, hyri në fuqi në mars 1992. Detyrimet që rrjedhin prej kësaj konvente përsa u takon respektimit të të drejtave të fëmijës udhëhiqen prej parimit të respektimit të “interesave më të mira të fëmijës”. Sipas KDF fëmija ka të drejtë të gëzojë një standard të pranueshëm jetese, sigurimi i të cilit është përgjegjësi e shtetit dhe e prindërve. Konventa e Hagës (1993) “Mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimet ndërkombëtare” u ratifikua me ligjin nr. 8624, datë 15 qershor 2000.

Kodi i ri i Familjes (ligji nr. 9062, datë 8 maj 2003) specifikon detyrimet institucionale të shtetit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe mënyrën se si duhet të trajtohen ato.

Në Kodin e Familjes “fëmijë pa kujdes prindëror” konsiderohen të gjithë këta fëmijë: prindërit e të cilëve kanë vdekur; prindërit e të cilëve janë shpallur të panjohur; prindërit e të cilëve janë shpallur të humbur; që janë braktisur nga prindërit; prindërit e të cilëve janë privuar nga e drejta e tyre prindërore në bazë të një vendimi përfundimtar gjykatë. (Kodi i Familjes (2003) fut një teknologji të re, bashkëkohore. Këtu përdoret termi “fëmijë pa kujdes prindëror” në vend të termit “jetim”. Ky përkufizim e zgjeron grupin e fëmijëve që përfitojnë, duke përfshirë këtu edhe fëmijët që janë pa kujdes prindëror ndonëse prindërit e tyre jetojnë.

### **2.9.3 Dokumentacioni për birësim**

- Kërkesën me motivimin e birësimit
- Të dhënat personale për marrëdhëniet ndërpersonale të anëtarëve të familjes, informacione për pjesëtarët e familjes dhe qëndrimin e tyre ndaj birësimit
- Të dhënat për gjendjen civile, si certifikatën e lindjes, certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit dhe fotokopje të kartës së identitetit
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të dhëna për fëmijërinë dhe mënyrën e rritjes
- Raportin mjekësor dhe historinë mjekësore të familjes
- Vërtetime të punësimit, të të ardhurave dhe të pasurisë së paluajtshme
- Vërtetimin e pronësisë së banesës dhe të dhëna për kushtet e banimit
- Vërtetimin për gjendjen ekonomike dhe sociale. Deklaratën për fëmijërinë, mënyrën e rritjes, edukimin dhe profesionin Deklaratën me të dhënat për gjendjen ekonomike dhe sociale
- Vërtetimin, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale
- Deklaratën e gatishmërisë së familjarëve dhe të miqve në mbështetje të aplikantit birësues. (<http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/ligji-per-biresimin.pdf>)



Pas dorëzimit të dokumenteve, prindërit ose aplikanti zhvillon një seancë këshillimore me psikologët dhe punonjësit socialë të institucionit. Më tej, procedura e aplikimit deri në marrjen e përshtatshmërisë zgjat 60 ditë, por varet nga disponibiliteti i aplikantit për t'ju nënshtruar kësaj të fundit. Birësimi është një proces i pakthyeshem dhe me një kosto financiare, e cila për të huajt ka një vlerë më të lartë.

***Nuk mund të birësohet*** një person nga i paralinduri, ose nga vëllezërit dhe motrat. Pra, prindi biologjik, gjyshi, gjyshja, stërgjyshi apo stërgjyshja, nuk mund të birësojë përkatësisht fëmijën e tij, nipin, mbesën, stërnipin apo stërmbesën. Kjo pengesë ligjore do të zbatohet pavarësisht nëse lidhja gjinore rrjedh nga martesë apo jashtë martese. (<https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al057sq.pdf>).

Në rastin e një fëmije të lindur jashtë martese prindi biologjik nuk mund ta birësojë fëmijën, por mund të kërkojë njohjen e atësisë ose amësisë. Në një rast të tillë, as gjyshi dhe gjyshja nuk mund ta birësojnë fëmijën por mund të kërkojnë të marrin kujdestarinë.

Nuk lejohet birësimi i të miturit nga kujdestari i tij, pa u parë më parë nga gjykata administrimi i pasurisë së të miturit.

I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë.

#### **2.9.4 Komiteti Shqiptar i Birësimit**

Në Shqipëri, Komiteti Shqiptar i Birësimit është i vetmi Autoritet Qëndror në fushën e birësimit, si të birësimit vendas ashtu edhe ndërvendas. Përcaktimi i birësimit ndërvendas është procesi i birësimit të fëmijëve nga familjet në një shtet tjetër të ndryshëm nga shteti i lindjes. Në statistikat e publikuara nga ky institucion të cilat i referohen respektivisht viteve 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 si edhe 2014, që numri i birësimeve ka pësuar një rritje nga viti në vit . ([http://kshb.gov.al/?page\\_id=65](http://kshb.gov.al/?page_id=65))vihetre).

Çdo person i cili është i interesuar të birësojë duhet t'i drejtohet me kërkesë Komitetit Shqiptar të Birësimit. Ky organ mbledh, vlerëson kërkesat për birësim të bërë nga shtetas të huaj dhe vendas, jep informacionet e nevojshme lidhur me plotësimin e dokumentacioneve, bashkëpunon me autoritetet publike dhe private të vendit dhe të huaja për të siguruar mbrojtjen e të miturve.

Në kërkesën për birësim personi duhet të parashtrojë edhe motivet për të cilat dëshiron të birësojë.

Shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë, i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit. Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, mund gjithashtu t'i

drejtohen drejtpërdrejt Komitetit([http://kshb.gov.al/?page\\_id=122](http://kshb.gov.al/?page_id=122)), me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të njihet në vendin ku ata jetojnë. Ata mund të birësojnë vetëm fëmijë, emrat e të cilëve janë në listat e Komitetit.

Shtetasit e huaj mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjencive ndërmjetësuese të vendit të tyre, të njohura si të tilla nga Komiteti. Shtetasit e huaj, që jetojnë prej dy vjetësh në Republikën e Shqipërisë, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, vetëm nëse legjislacioni i tyre kombëtar e lejon birësimin.

### 3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Birësimi është një institucion social, një shërbim social i cili ndodh brenda kontekstit kulturor, politik dhe ekonomik të një vendi. Birësimi konsiderohet një çështje shumë delikate dhe private në Kosovë dhe në bote në përgjithësi. Si e tillë, marrëdhënia që krijohet nga birësimi shoqërohet jo pak herë me paragjykime dhe dyshime nga familjarët dhe vetë rrethi shoqëror i familjes birësuese.

Mungesa e lidhjes së gjakut e vë në dyshim lumturinë e kësaj lidhjeje ligjore. Kjo, sepse ne jemi të prirur të pranojmë si ‘normale’ atë formë të krijimit të familjes që është natyrale dhe birësimi nuk është. Njerëzit mendojnë se një familje birësuese nuk është e njëjtë me atë biologjike, kjo sepse një fëmijë i braktisur, i ekspozuar ndaj problemeve psikologjike dhe emocionale që janë të lidhura drejtëpërsëdrejti me braktisjen, nuk lejojnë fëmijën të atashohet plotësisht me prindërit birësues dhe mjedisin e ri familjar.

Rritja e një fëmije të birësuar ndryshon nga rritja e një fëmije biologjik në familje në disa drejtime: fëmijët e birësuar ndryshojnë nga fëmijët biologjikë pasi ata bëhen pjesë e familjes me anë të mjeteve sociale dhe ligjore të referuara si ‘institucioni i birësimit’; rritja e një fëmije të birësuar pa lidhje gjaku me prindërit krijon për prindin, por edhe fëmijën sfida të cilat vazhdojnë gjatë gjithë jetës duke përfshirë futjen e fëmijës në shkollë, adoleshencën, martesën etj (këtu përfshihet edhe sfida që kanë disa prindër në lidhje me momentin, kohën se kur duhet të flasin për birësimin me mësuesin, komshinjtë, shoqërinë).

‘Sindroma e fëmijëve të birësuar (Ana)’ përfshin ‘veshjen’ që njerëzit i bëjnë të birësuarve si të keqpërshtatur. Shpesh herë stigma lejon shoqërinë që të justifikojë diskriminimin ndaj të birësuarve. Shumica e njerëzve e konsiderojnë një fëmijë të lindur ligjërisht nga dy prindër të martuar dhe më pas të vendosur për birësim aq të paligjshme, sa një fëmijë të lindur nga një nënë beqare.

Kështu duke lidhur statusin e birësimit me paligjshmërinë, shoqëria e vendos në të njëjtin status. Në një studim kërkimor të realizuar nga Instituti i Birësimit të Donaldson, u raportua se 1 në 3 nga 1554 (Smoll) amerikanë mendojnë se fëmijët e birësuar, si një grup, janë më ‘i pasigurt dhe më i prirur për probleme të sjelljes dhe arritjeve akademike’ nga fëmijët e pabirësuar.

Fëmijët e birësuar janë në risk me më shumë shanse për keq – zhvillim psiko - social në krahasim me fëmijët të rritur nga prindërit e tyre biologjikë në familjet e tyre. Këta fëmijë duke u ndjerë ndryshe e duke pasur ndjesinë e të mos përkulturit, kalojnë në pasiguri kronike, humbje të ndjeshmërisë, rritjen e mosbesimit’ (Benet) etj. Po sipas studjuesit Joanne Wolf Smoll ka një

mbipërfaqësim të fëmijëve të birësuar midis popullatës klinike ndonëse nuk ka një arsye pse, spekulimet theksojnë se prindërit të cilët kanë përdorur shërbimet sociale për të birësuar, madje edhe individët e birësuar të cilët kanë kërkuar informacion mbi origjinën e tyre biologjike, janë parë si të keqtrajtuar psikologjikisht ndoshta për shkak të disa dështimeve nga ana e prindërve birësues (Nations).

## 4 METODOLOGJIA

Si aspekte kryesore të sferës metodologjike mund të paraqiten:

- studimin e dokumenteve që burojnë nga familjet biresuese apo simpatizuesit e tyre;
- hulumtimin e librave dhe artikujve akademikë mbi adaptimin;
- studimin e informacionit mbi adaptimin që vjen nga mediat;
- intervistat me zyrtarë qeveritarë që merren me adaptimin;
- studimin e dokumenteve të hapura qeveritare;
- studimin e dokumenteve të gjykatave që lidhen me proceset e adaptimit
- studimin e dokumenteve të klasifikuara qeveritare;
- studimin e transkripteve nga hetimi dhe/ose marrja në pyetje e familjeve adaptuese.

Ne kete studim eshte bere nje analize krahauese mes proceseve te adpatimit ne Kosove, Shqiperi dhe ne Republiken e Maqedonise. Duke marre parasysh kufizimin e realizimit te ndonje studimi sasior ne keto institucione si metode kyce eshte perdorur metoda e rishikimit te literatures dhe ne baze te informcionit te mbledhur eshte dizajnuar dhe ky hulumtim

## **5 Prezantimi dhe analiza e rezultateve**

### **5.1 Prezantimi I rezultateve**

Si rezultat i këtij punimi vihet në përfundim se cilat janë shkaqet të cilat shpijen deri tek braktisja e fëmijeve ,cili është qëllimi kryesor i adoptimit ,llojet e adoptimit sipas doktrines juridike , si gjykohen birësimet në Kosovë ?

Po ashtu gjatë hulumtimit ka pasur raste kur parashtruesi i kërkesës për adoptim ka qenë shtetas i huaj , si është vendosur në këto raste ?

Gjithashtu bëhet krahasimi ne mes Kosovës , Shqipërisë dhe Maqedonis se si janë statistikat e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror , ku është shifra më e ulët e braktisjes se fëmijeve e ku më e lartë. Cilët fëmijë mundë të birësohen ?

Tregohen po ashtu procedurat e adoptimit, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave te adoptusit dhe personit të adoptuar,dokumentet e nevojshme për adoptim etj.

### **5.2 Analiza e rezultateve**

Gjatë punimit te kësaj teme diplome jemi muduar që paraqitja e rezultateve të jetë ne mënyrë sa më të saktë pasi që adoptimit është qështje mjaft e ndishme sepse në rend të parë bëhet fjalë per interesat e te miturve, mbrojtja e fëmijëve të braktisur dhe sigurimi I mirëqenies në kuadër të një familje.

Nga hulumtimet vihet në përfundim edhe për arsyet te cilat shpijen deri tek deklarimi i prindërve per braktisjen e fëmijëve te cilat janë :gjendja e rëndë socio-ekonomike ,shtatëzanit e padëshiruara dhe të paplanifikuara, mungesa e vullnetit të partnerit për të marrë përgjegjësi për një fëmijë jashtë martesor ose pas ndarjes së një qifti .

Duhet analizuar , mbikqyren rregullat etike dhe profesionale për stafin i cili merret me fëmijët e braktisur , me qëllim të shmangies nga rreziqet që mund ti kanosen fëmijës në rast të mosrespektimit të konfidencialitetit.Duhet të rritet përgjegjësia e QPS-ve në mbrojtjen e fëmijëve të braktisur ,pasi që stafi I QPS-ve është një staf i cili ka në dorë te tashmen dhe të ardhmen e atyre fëmijëve.

## **6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

### **6.1 Përfundime**

Përpara periudhës së tranzicionit Kosova konsiderohej si një vend me nivel të ulët braktisjeje dhe shpërfilljeje të fëmijëve. Shndërrimet ekonomike dhe sociale gjatë periudhës së tranzicionit në vitet '90 e rritën mjaft numrin e fëmijëve të rrezikuar (Dr. Hamdi Podvorica). Varfëria, papunësia dhe nivelet e larta të emigrimit çuan në rritjen e numrit të fëmijëve të braktisur, të shpërfillur ose të abuzuar nga prindët e tyre (Sociale). Deri në fillim të viteve '90 pjesa më e madhe e fëmijëve të vendosur në institucionet publike të kujdesit social ishin jetimë biologjikë; sot jetimët socialë përbëjnë kontigjentin më të madh. (Qendra Kombëtare për Studime Sociale; 2005).

Gjatë 10 viteve të fundit situata e numrit të fëmijëve të birësuar në Kosove krahasuar me vende të tjera të rajonit është e ulët. (Ana) Shkaqet lidhen kryesisht me: numrin e ulët të braktisjes së fëmijëve dhe fertilitetin. Gjithashtu në këto vite janë zhvilluar dhe forcuar format alternative të kujdesit, përfshirë birësimin, kujdestarinë dhe kujdesin në shtëpitë familje, ka patur zhvillime pozitive në politikën dhe praktikën e birësimit dhe procesi menaxhohet nga një administratë profesionale (Vojcic). Proçedurat e birësimit janë të qarta e fokusohen në interesin më të mirë të fëmijës. Kuadri ligjor mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosove është relativisht bashkëkohës. Sfidat më të rëndësishme janë forcimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e tij; zgjerimi i shërbimeve sa më afër aplikuesit/përfituesit që të jetë e mundur si dhe vëzhgimi dhe raportimi për zbatimin e tyre (Emanuel).

## 6.2 Rekomandime

- Insituti i birësimit konsiderohet një akt juridik solemn, me anë të të cilit synohet të vendosen, mes birësuesit dhe të birësuarit, marrëdhënie të njëjta si ato të gjinisë. Prioritet kryesor i duhet dhënë për ti lejuar fëmijës të rritet në gjirin e familjes së tij.
- Birësueshmëria nuk është vetëm një situatë juridike. Ajo duhet të marrë parasysh disa elemente, si psikologjike, sociale, mjeksore dhe juridike.
- Qëllimi i birësimit është që ti sigurohet fëmijës që i është privuar ose jo mjedisi familjar mundësia tëvendoset në mënyrë të përhershme në një familje birësuese. Prioritet i duhet dhënë fëmijës për të lejuar që të rritet në gjirin e familjes së birësuese.
- Qeveria dhe shoqëritë civile duhet të tregojnë një përkushtim të veçantë për familjet e origjinës për t'ju krijuar në këtë mënyrë mundësitë që të kujdesen për fëmijët e tyre.
- Formulim i politikave dhe i programeve të cilat kujdesen për zhvillimin njerëzor dhe drejtësinë sociale, duke i ofruar familjeve dhe nënave në vështirësi mbështetje psikologjike, sociale dhe financiare.
- Birësimi ndërkombëtar është ndihmës për birësimin kombëtar. Vendimi për një birësim ndërkombëtar duhet marrë vetëm pasi më parë të jetë kërkuar, pas asnjë rezultat, apo një zgjidhje e kënaqshme në vendin e tij të origjinës.
- Birësueshmëri e fëmijës duhet të vendoset përpara se të ndërmerret procesi i birësimit. Pra ky vendim nuk do të vihet në zbatim pa u nisur nga një studim psiko-mjeko-social të fëmijës dhe familjes së tij të origjinës. Familja birësuese duhet të cilësohet paraprakisht e njohur si e kualifikuar., përpara se të ndërmerret praktika e birësimit.
- Aksesit në dokumentat e tyre do të jetë i mirë përcaktuar. Fëmija, prindërit biologjikë dhe familja birësuese gëzojnë të drejtën e konfidencialitetit dhe të respektimit të jetës së tyre.
- Urdhëri i birësimit jepet nga organet kompetete për realizimin e procedurës së birësimit.
- Mungesa e një kufiri të përcaktuar moshe për birësuesin has probleme në zbatimin e drejtë të ligjit. Për këtë arsye, është e domosdoshme përcaktimi i moshës së prindit birësues.
- Organi kompetent për përfundimin e procedurës së birësimit është gjykata. Vendimi i gjykatës, me anë të të cilit pranohet kërkesa për birësim, vendos birësimin e plotë dhe të përvokueshëm. Kjo nënkupton se fëmija i jep fund të gjitha raporteve formale dhe substanciale me familjen e origjinës.



- Si legjislacioni vendas ashtu edhe ai nërvendas barazojnë statusin e fëmijës biologjik me atë të fëmijës së birësuar.
- Legjislacioni shqiptar i birësimit nuk e njeh birësimin jo të plotë, sipas të cilit fëmija i birësuar i mban lidhjet me familjen biologjike. Pra pas birësimit, i birësuari shkëput çdo marrëdhënie juridike me familjen juridike.
- ***Familja*** është dhe do mbetet ambjenti ***IDEAL*** për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës!!!

## 7 BIBLIOGRAFIA

1. . L. Altman, J. Canter, P. A. Patrick, N. Daley, N. K. Butt dhe D. A. Brand (2011). . Parent Education by Maternity nurses of abusive head trauma. n.d.
2. Ana, Rubik. “Research note Adoption in European Union. 2002.
3. Benet, Mc Kurtne. . (1976). The Character of Adoption. London: Jonathan CAPW. 1976.
4. Dr. Hamdi Podvorica. E Drejta Familjare, fq. 203. 2006.
5. Duncan, w. (1993),. “The Hague convention on the protection of children and co-operation in respect of intercountry adoption”, . n.d.
6. E drejta familjare, Prishtinë, 1994, fq.179. GANI ORUCI. n.d.
7. Emanuel, Charlene. The stigma of adoptive parent status: Perceptions of community attitudes toward adoption and the experience of informal social sanctioning. 2008.
8. Erden, . Bartholet. International adoption: Thoughts on the Human Rights issues. 2007.
9. Erikson, Eric. Fazat e zhvillimit të personalitetit –. 2006.
10. Familjen, Ligji për. Kuvendi i Kosoves. n.d.
11. Institute, Evan B. Donaldson Adoption. 2012.
12. Kajtazi, Murat. Analizë e SHKURTËR MBI AVANCIMIN E mbrojtjes. 2014.
13. Kosovës, Ligji mbi Familjen i. , Mbikëqyrja nga Organi i Kujdestarisë, . n.d.
14. Lammerant I., M. Hofstetter. Adoption: at what cost? . 2007.
15. Marital, Dimkpa DI. Adjustment roles of couples practicing child adoption. 2014.
16. Meredith Lammers. UNICEF (2007), TRANSMONEE 2007 Features,. 2008.
17. Mira Alinčić, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac-Lozić, Aleksandra Korać-Graovac. Adoption in Macedonia. 2017.
18. Nations, United. Yearly report on adaption. 2015.
19. Nderkombetar, Sherbimi Social. TE DREJTAT E FEMIJEVE NE BIRESIMIN. 2008.

20. Sociale, Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime. Adoptimi ne Shqiperi. 2005.
21. The Evan B. Donaldson Adoption Institute. 2010.
22. UNICEF. Adoption in Albania. 2016.
23. Vojcic, Muter. ‘Impact of adoption on adoptive parents’; Child welfare Information . 2016.
24. Vojislav Bakić. E Drejta Familjare . fq. 267, 2003.
25. . L. Altman, J. Canter, P. A. Patrick, N. Daley, N. K. Butt dhe D. A. Brand (2011). . Parent Education by Maternity nurses of abusive head trauma. n.d.
26. Ana, Rubik. “Research note Adoption in European Union. 2002.
27. Benet, Mc Kurtne. . (1976). The Character of Adoption. London: Jonathan CAPW. 1976.
28. Brodzinsk, David. y: The Psychology of Adoption (1990). 1990.
29. Browne, K.D., Hamilton-Giacritsis, C.E., Johnson, R., Agathonos,. Mapping the number and characteristics of children under three in institutions . 2004.
30. Donaldson, . Evan B. Adoption Institute (March 2012) ‘Openness in doption: from secrecy and stigma to knowledge and connections’ . 2012.
31. Dr. Hamdi Podvorica. E Drejta Familjare, fq. 203. 2006.
32. Duncan, w. (1993),. “The Hague convention on the protection ofchildren and co-operation in respect of intercountry adoption”, . n.d.
33. E drejta familjare, Prishtinë, 1994, fq.179. GANI ORUCI. n.d.